



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 204 Datë 13.09.2018

MBI

**PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN GUSHT 2018**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 86, të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar; “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 201, datë 04.12.2017, e ndryshuar, nenit 15 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 03.09.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.09.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit” për muajin gusht 2018,

Konstatoi se:

- OSHEE sha, me shkresën Nr. 16436 Prot, datë 27.08.2018, paraqiti në ERE aplikimin për çmimin e shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin Gusht 2018.
- Informacioni i dërguar në këtë shkresë është përgatitur në mbështetje të Vendimit të Bordit të ERE-s nr 144, datë 25.06.2018 mbi rishikimin e “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, pikërisht neni 8 i rishikuar i “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 201, datë 04.12.2017.
- Duke u mbështetur në formulën perlllogaritese të nenit 8, OSHEE sha, ka përcaktuar çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin gusht 2018 prej 12,86 leke/kWh.

- Prodhimi i pergjithshem i Prodhuesve me Perparesi dhe KESH per muajin gusht 2018 ka qene i mjaftueshem per te mbuluar kerkesat per klientet Fundor FSHU, per mbulimin e humbjeve dhe per furnizimin e klienteve te FMF. Per rrjedhim, kerkesa per klientet e FMF per muajin Gusht 2018 eshte mbuluar nga prodhimi i energjise nga prodhuesit me perparesi me cmimin 8.5652 Lekë/kWh ne baze te Vendimit Nr. 19, datë 19.01.2018 të Bordit të ERE-s.
- OSHEE sh.a., me shkresen nr 8814/1 date 24.5.2018, deklaroi se nuk ka ndarje te llogarive midis aktivitetit te Furnizimit dhe Shperndarjes dhe nuk ka nje strukture te posacme per evidentimin e kostove te administrimit dhe kostot e disbalancave per klientet e FMF. Per rrjedhoje, eshte e arsyeshme qe, per sa kohe qe nuk ka ndarje te llogarive midis aktiviteteve dhe mungon struktura per evidentimin e kostove per klientet FMF, per percaktimin e kostove administrative te pranohet si e arsyeshme vlera prej 1,79 lekë/kWh e deklaruar nga OSHEE sh.a..
- Ne vijim me ndarjen administrative /organizative te OSHEE sipas aktiviteteve do të jetë e mundur saktësimi i këtyre kostove dhe axhustimi i tyre për periudhat e mëparshme në përputhje me “Metodologjinë e përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”.
- Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit, miratur me Vendimin Nr. 210, Datë 28.12.2017 *“Për miratimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike nga OST sh.a. për vitin 2018”* është 0.75 leke/kWh
- Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 35 kV, miratur me Vendimin Nr. 211, Datë 28.12.2017 *“Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të OSHEE sh.a. për tarifën e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike sipas nivelit të tensionit dhe lënien në fuqi të çmimeve me pakicë për klientët që shërbehen nga furnizuesi i shërbimit universal për vitin 2018”* është 1.5 leke/kWh.
- Nga verifikimi i informacionit dhe perlllogaritjeve te paraqitura nga shoqeria rezulton se cmimi per shitjen e energjise elektrike per klientet ne kushtet e FMF per muajin gusht 2018 eshte 12.86 lekë/kWh.
- OSHEE sh.a. nuk ka llogaritur kostot e disbalancave per klientet FMF.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të miratoje e çmimit të furnizimit me energji elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit prej 12,86 lekë/kWh për muajin Gusht 2018.
2. Drejtoria e Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI